



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 07.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.P."VETONI" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i stadiumit në Novosellë", Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.N.P."VETONI", e dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i stadiumit në Novosellë", Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 21.07.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. PËRMISOHET PJESËRISHT DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, TË PUBLIKUAR ME DATË: 21.07.2026;**
- 3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e pjesërishëm të Dosjes së tenderit .**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .**

A r s y e t i m

Operatori ekonomik N.N.P."VETONI". me dt. 07.08.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stadiumit në Novosellë ", Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 12.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

- **Pretendimi i parë** sa i përket pajisjes (Nr.1) *Kamion kiper me kran, me peshë bartëse 7–9 t, me atest*, vlerësohet si i bazuar. Pas shqyrtimit, kjo kërkesë korrigjohet, duke ndryshuar peshën bartëse nga 7–9 t në 5–9 t;
- **Pretendimi i dytë** sa i përket pajisjes (Nr.2) *Kamion kiper kran me peshë bartëse max 1t*, vlerësohet si i bazuar. Pas shqyrtimit, kjo kërkesë korrigjohet, duke ndryshuar peshën bartëse nga 1 t në 2.5 t;
- **Pretendimi i tretë** sa i përket pajisjes (Nr.5) *Tuba për largimin e mbeturinave së paku 60m*, vlerësohet si i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
- **Pretendimi i katërt** sa i përket pajisjes (Nr.10) *Gjysëmrinokio me peshë bartëse maximumi 2.5 t me kiper dhe kran*, vlerësohet si i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
- **Pretendimi i pestë** sa i përket pajisjes (Nr.11) *Hillt demolues me derivate*, vlerësohet si i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
- **Pretendimi i gjashtë** sa i përket pajisjes (Nr.12) *Ndriçues me gjenerator me katër (4) llampa me peshë 1-2 t*, kjo kërkesë korrigjohet, duke ndryshuar peshën bartëse nga 1 t në 3 t;
- **Pretendimi i shtatë** sa i përket pajisjes (Nr.14) *Karroçë elektrike kiper max 150 kg*, vlerësohet si i bazuar dhe hiqet nga kriteret;
- **Pretendimi i tetë** sa i përket pajisjes (Nr.15) *Mini ekavator me peshë max 1 t*, kjo kërkesë korrigjohet, duke ndryshuar peshën bartëse nga 1 t në 2 t;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

*Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;*

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).